



Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës

IHK "INFRAKOS" Sh.A. – Fushë Kosovë

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

DHE PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

Prishtinë, Qershor 2020

Përmbajtja

Informatat e përgjithshme.....	3
Raporti i auditorit të pamvarur.....	4
Pasqyra e Pozitës financiare	7
Pasqyra e të Ardhurave.....	8
Pasqyra e ndërrimeve të ekuitetit.....	9
Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme.....	10
Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin 2018	11
Përmbledhja e politikave domethënëse të kontabilitetit.....	14

Informata të Përgjithshme

Organet e Ngarkuara me Qeverisjen:

- z. Enver Aruqaj, Kryesues i Bordit të Drejtorëve
- z. Lundrim Camaj, Anëtar i Bordit të Drejtorëve
- z. Enis Berisha, Anëtar i Bordit të Drejtorëve,
- z. Shkëlqim Osmani, Anëtar i Bordit të Drejtorëve
- z. Nagip Skenderi, Anëtar i Bordit të Drejtorëve
- z. Arben Dodaj, Anëtar i Bordit të Drejtorëve

Menaxhmenti:

Xhevat Ramosaj – UD. Kryeshef Ekzekutiv

Zymer Zekaj – Zyrtar Kryesor Financiar

Adresa:

Sheshi i Lirisë pn.

12000 Fushë Kosovë.

Banka Koresponduese:

ProCredit Bankë,

Auditorë:

Kompania e Licencuara "H&N" Sh.p. k

Rruga Ilaz Kodra nr.29

10000 Prishtinë, Kosovë

Kontakti: auditimit@gmail.com,

Tel: 038 / 541 144

Drejtimi-Menaxhmenti



RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR

Për: Aksionarët dhe Menaxhmentin e I.H.K. Infrakos SH. A.

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të IHK "INFRAKOS" SH.A., me adresë: Rruga "Sheshi i Lirisë" pn, Fushë Kosovë të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për), pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2019, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim i çështjes

- Siç është shpalosur në Shënimin 7- Aktivet materiale afatgjata, testimet tona kanë vërejtur se kompania nuk ka bërë rivlerësim të aktiveve materiale të saja siç janë toka, ndertesa, infrastruktura e hekurudhës dhe paisjet që nga viti 2005 që është një periudhë e gjatë kohore. Ne nuk kemi siguri se aktivet materiale janë paraqitur me vlerën e drejtë për ushtrimin nën auditim. Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 16-Aktivete materiale kërkon që nëse vlera e drejtë e një aktivi ndryshon materialisht nga vlera e tij kontabël (neto), është i nevojshëm një rivlerësim i mëtejshëm si dhe
- Siç është shpalosur në Shënimin 20 që lidhet edhe me Parimin e Vijimësisë – ku testimet tona kanë vërejtur se edhe për ushtrimin nën auditim kompania ka pasë vështërsi afariste çka ka rezultuar te afaroj me rezultat negativ financiar (humbje). Ende Aksionari dhe Ministria e Infrastrukturës e Republikës së Kosovës nuk kanë arritë që në plotëni të përmbushin obligimet financiare. Po ashtu, ende nuk janë përmbushë kërkesat e nenit 63 pika 3 të Ligjit nr 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës për vendosjen e marrëveshtjes kontraktuale në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe "Infrakos" Sh.A.

Çështjet kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, ishin më të rëndësishmet në auditimin tonë të pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje u adresuan në kontekstin e auditimit tonë të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tonë mbi të, dhe ne nuk shprehim një opinion të veçantë për këto çështje.

Çështje tjera

Pasqyrat financiare IHK" INFRAKOS" SHA për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018, janë audituar nga kompania audituese "H&N" Shpk për të cilat ka shprehur një opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, për ato pasqyra financiare më 20 mars 2019.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullative

Opinion mbi Raportin e Menaxhmentit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Kompanisë IHK "INFRAKOS" SH.A. si dhe informacionin e shkruar në raportin e menaxhmentit bazuar në kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 10.

Sipas opinionit tonë raporti i menaxhmentit është në përputhje me pasqyrat financiare për vitin financiar raportues si dhe është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, neni 10, dhe UA Nr.02/2019 për pavarësinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit.

Raport mbi kërkesat tjera

- Ne jemi angazhuar si auditor të kompanisë IHK "INFRAKOS" SH.A. për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019, sipas kontratës të nënshkruar me numer protolli NR.50, datë 16.01.2019 nga Departamenti i Prokurimit të Kompanisë, përmes Ofertës së hapur të pjesëmarrjes në tender dhe kemi fituar Kontratë dyvjeqare për auditimin e PF për vitet 2018 dhe 2019.

Rreziqet kryesore janë ato rreziqe që, sipas gjykimit profesional të auditorit, kishin më shumë rëndësi në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe përfshijnë rreziqet më të rëndësishme të vlerësuara nga keq-deklarimi material (pavarësisht nëse janë apo jo për shkak të mashtrimit) të identifikuar nga auditorët, përfshirë ata që kanë efektin më të madh në: strategjinë e përgjithshme të auditimit; alokimi i burimeve në auditim; dhe drejtimin e përpjekjeve të ekipit të angazhimit. Këto çështje, dhe çdo koment që bëjmë në lidhje me rezultatet e procedurave tona, janë adresuar në kontekstin e auditimit tonë të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e mendimit tonë mbi të, dhe ne nuk japim një mendim të veçantë për këto çështje. Kjo nuk është një listë e plotë e të gjitha rreziqeve të identifikuar nga auditimi ynë.

Vijimësia-edhe gjatë vitit 2019 INFRAKOS SHA është përballur me vështërsi të mëdha afariste e posaqërisht nga aspekti i likuiditetit. Kështu ende nuk është nënshkruar marrëveshtja pesë (5) vjeçare financiare ndërmjet qeverisë dhe INFRAKOS-it, marrëveshtje kjo e paraparë me Ligjin mbi Hekurudhat e Kosovës nr 04/L-063.

Sipas situatës momentale, të hyrat kryesore të INFRAKOS SHA nuk mvaren nga kompania, por mvaren nga operatorët e transportit hekurudhor si atij publik (TRAINKOS) dhe atij privat (RAILTRANS), të cilët do të duheshin të

bëjnë pagesën për shfrytëzimin e traseve hekurudhore për qarkulimin e trenave. Për më tepër nga viti në vitë ka rënje të transportit të udhëtarve e sidomos të transportit të mallërave (eliminimi i disa vijave hekurudhore).

Menaxhimi i pronave - nga patundshmëria INFRAKOS SH.A. ka të hyrën e dytë ma të madhe, kështu që edhe për vitin 2019 është vërejtë se ka probleme në menaxhim dhe inkasime. Kështu ende ka probleme me uzurpime të pronave dhe shfrytëzime pa marrëveshje kontraktuale të pronave të kompanisë, mandej probleme në inkasime të të hyrave ku vërehet nga numri i madhë i lëndëve të dërguara në gjykata apo te përmbaruesi privat.

Vështërsi në pagesën e obligimeve - kemi vërejtë vështërsi të mëdha në pagesën e obligimeve si për të punësuarit ashtu edhe për të tretët siç janë obligimet për taksa, contribute dhe ndaj furnitorve.

- Ne kemi dizajnuar procedurat e auditimit në mënyrë që t'iu përgjigjemi rreziqeve të identifikuar për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshmet dhe për të fituar siguri të arsyeshme lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese.

- Ne konfirmojmë që opinioni i auditimit është në përputhje me raportin shtesë për komitetin e auditimit.

- Ne deklarojmë që nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo audituese të përmendura në UA nr.02/2019 për pavarësinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit, Neni 5 dhe ne jemi të pavarur ndaj subjektit të audituar gjatë kryerjes së auditimit;

Me respekt,

Hysen Ramabaja, Partner i auditimit

"H&N" SH.P.K.

Rruga Ilaz Kodra nr.29
10000 Prishtinë, Kosovë
01 Qershor 2020



"INFRAKOS" SH.A.
Pasqyra e pozitës financiare më 31 dhjetor 2019

	Shënimi	2019 €	2018 €
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	166,317	40,846
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	2,629,518	2,927,343
Stoqet	6	804,080	838,225
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		3,599,916	3,806,415
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	7	18,778,996	19,765,508
Gjithsej pasuritë afatgjata		18,778,996	19,765,508
Gjithsej pasuritë		22,378,912	23,571,923
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	8	877,128	1,649,797
Tatimet e pagueshme aktuale	9	937,465	765,097
Të hyrat e shtyra	10	7,325,294	7,903,987
Detyrimet e tjera afatshkurtra	11	149,036	204,842
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		9,288,923	10,523,724
Detyrimet afatgjata			
Detyrimet e shtyra tatimore	12	485,591	257,703
Gjithsej detyrimet afatgjata		485,591	257,703
Gjithsej detyrimet		9,774,514	10,781,427
EKUITETI			
Kapitali aksionar	13	3,027	25,000
Fitimet/humbjet e mbajtura	13	-2,624,644	-2,461,020
Rezervat e tjera	13	15,226,015	15,226,516
Gjithsej ekuiteti		12,604,398	12,790,496
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		22,378,912	23,571,923

U.D Kryeshef Ekzekutiv
Xhevat Ramosaj



ZKF. Zymer Zekaj

Kontab.Çertifikuar:
Isa Derguti:

Shënimet nga numri 1 deri në numrin 20 janë pjesë përbërse e këtyre Pasqyrave Financiare

"INFRAKOS" SH.A.

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

	Shënimi	2019	2018
		€	€
Të hyrat nga shitja	14	1,576,775	1,349,683
Të hyrat tjera afariste	14	999,999	586,500
Të hyrat shtyra	14	1,018,707	914,617
Fitimi / (humbja) bruto		3,595,481	2850800.51
Shpenzimet e shpërndarjes	15	-3,277,708	-3,212,738
Shpenzimet administrative	15	-481,397	-402,341
Fitimi / (humbja) operativ		-3,759,105	-3,615,078
Fitimi / (humbja) para tatimit	16	-163,624	-764,278
Shpenzimet e tatimit në fitim		0	0
Fitimi / (humbja) i/e vitit		-163,624	-764,278

Shënimet nga numri 1 deri në numrin 18 janë pjesë përbërse e këtyre Pasqyrave Financiare

"INFRAKOS" SH.A.
Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

	Shënimi	2019 €	2018 €
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) i / e vitit	16	-163,624	-764,279
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	15	1,197,807	1,109,234
Shpenzimet financiare	15	740.53	1,124.49
		1,034,924	346,079
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	297,825	456,074
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	6	34,145	31,400.03
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	8	-877,128	-1,649,797
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	9	(400,281)	683,004
		-945,440	-133,239
Interesi i paguar			
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		89,484	212,840
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	7	(964,011.95)	798,994.63
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve			-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		-964,012	798994.63
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Arkëtimet nga donacionet dhe subvencionet qeveritare	14	999,999	586,500.00
Pagesat e lizingut financiar			
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		999,999 0	586,500
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		125,471	-586,154
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		40846	627000
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	4	166,317	40,846

"INFRAKOS " SH.A.
Pasqyra e ndryshimeve ne ekuitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
	€	€	€	€
Gjendja më 1 janar 2018	<u>25,000.00</u>	<u>-1,695,609</u>	<u>15,226,023</u>	<u>13,555,414</u>
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	-764,278		-764,278
Ndarja e rezervave	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>0</u>
Gjendja më 31 dhjetor 2018	25000	-2,459,887	15,226,023	12,791,136
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	-163,624	-	-163,624
Terheqjet e kapitalit	-21,973	0	0	-21,973
Ndarja e rezervave	<u>-</u>	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>-</u>
Gjendja më 31 dhjetor 2019	3,027.2	-2,623,512	15,226,023	12,605,539

Shënimet e pasqyrave financiare

1. Të përgjithshme

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutes së Republikës së Kosovës, Neni 33 paragrafi 1, të Ligjit mbi Hekurudhat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-076, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës Nr.01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 26 Shkurt 2010 mori Vendim mbi ndarjen e Hekurudhave të Kosovës SH.A.

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-087, për "Kompanitë Publike"; Ligjit Nr.02/L-123, për "Kompanitë Tregtare" dhe bazuar në vendimin e Qeverisë nr.05/110 të datës 26.02.2010 për ndarjen e Hekurudhat e Kosovës SH.A. , themelon:

Shoqërinë Aksionare "Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës SH.A." me numër të biznesit 70325327, e cila është përgjegjëse për asetet, pronën, dhe gëzon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin si pasojë e këtij transformimi.

Shkurtesa e emërimit është "INFRAKOS" SH.A.

Selia e kompanisë gjendet në Komunën e Fushë Kosovës "Sheshi i Lirisë" pn. Kompania mund të zhvillojë aktivitetin e saj në territorin e Kosovës dhe jashtë saj.

Kompania, sipas Statutit të saj dhe Legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës mund të hapë Qendra zyra përfaqësuese, filiale, degë dhe kompani të tjera si në Republikën e Kosovës ashtu edhe jashtë vendit.

Shthurja financiare e Hekurudhave të Kosovës SH.A. është bërë nga grupi punues i përbërë prej tetë anëtarëve bazuar në vendimin e dates 18.05.2010 Nr.571. në bazë të cilit vendim është bërë ndarja e mjeteve financiare, ndarja e borxheve dhe ndarja e obligimeve financiare në dy kompani të reja "INFRAKOS" SH.A. dhe "TRAINKOS"

Aktivitetet biznesore të kompanisë

Fushëveprimi kryesorë i kompanisë është; Menaxhimi, mirëmbajtja, renovimi, përmirësimi dhe ndërtimi i infra-strukturës hekurudhore (linjave hekurudhore, stabilimenteve sinjalo-siguruese, stabilimenteve telekomunikuese, stabilimenteve të energjetikës, objekteve të stacineve dhe objekteve tjera për ofrimin e shërbimeve) ofrimi i shërbimeve në terminalët e mallrave, menaxhimi, mirëmbajtja, renovimi, ndërtimi dhe dhënia në shfrytëzim e pronës dhe objekteve të Infrastruktures hekurudhore për përfitime komerciale, menaxhimin e trafikut hekurudhor nëpër të gjitha linjat hekurudhore të Kosovës dhe pjesët e linjave të cilat e lidhin Kosovën me shtetet fqinje, si dhe ofrimin e të gjitha shërbimeve tjera të nevojshme për të gjitha ndërmarrjet hekurudhore (operatorët me trena).

1.2 Personeli i Kompanisë

Gjatë vitit ushtrimor Janar - Dhjetor 2018, Kompania kishte mesatarisht 316 të punësuar, gjersa gjatë vitit ushtrimor Janar - Dhjetor 2019 kishte mesatarisht 308 të punësuar.

2. POLITIKAVE Ë KONTABILITETIT

Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në mënyrë konsistente, dhe poqese nuk ceket ndryshe. Pasqyrat financiare janë të paraqitura ne Euro. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në pajtueshmëri me Standardet Nderkombëtare të Raportimit Financiar(SNRF-të).

Përgatitja e pasqyrave financiare konforme me SNRF-të kërkon përdorimin e parashikimeve të shpeshta kritike të kontabilitetit. Gjithashtu kërkojnë menaxhmentit të ushtrojnë gjykimin e tyre në proceset e aplikimit të politikave të kontabilitetit.

Periodha raportuese e Shoqërisë përfshin një periudhë dymbëdhjetë mujore duke përfunduar me 31 Dhjetor të çdo viti.

Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë krahasuese duke paraqitur në këtë mënyrë saldot për vitin e tanishëm dhe të kaluar.

Sikur vitet paraprake ashtu edhe aktualisht Kompania është e varur nga grantet e dhuruara nga komuniteti vendor dhe ndërkombëtarë, që ti mundësoj Kompanisë të vazhdoj me operimet e saj biznesore në të ardhmen.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtim me Parimin e vijimësisë sipas së cilit Kompania do të vazhdoi vijueshmërinë e aktiviteteve të veta edhe në të ardhmen.

2.1 Valuta e këmbimit

Monedha raportuese e INFRAKOS SH.A. është njësia monetare e Unionit European (Euro). Transaksionet në monedhat tjera përveç euros janë të regjistruara sipas kursit të këmbimit sipas datave të transaksioneve.

Transaksionet e valutës së huaj konvertohen duke përdorur normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Çfarëdo lloj përfitimesh apo humbesh, që kanë të bëjnë me harmonizimin e shumave, të pagueshme ose të arkëtueshme, njihen në pasqyrën e të ardhurave.

2.2 Prona, impiantet dhe paisjet

Vlerësimi i pronës, impianteve dhe pajisjeve të INFRAKOS SH.A. është kryer nga vlerësues të pavarur të kualifikuar dhe profesional të zvogëluara me një koeficient që sipas tyre është i aplikuar dhe në harmoni me standardet, ku data efektive e vlerësimit është 01 Janar 2005 (kohë e menagjuar edhe nga ndërkombëtarët).

Zërat e pronës, impianteve dhe paisjeve me 01.01.2005 janë bartur sipas kostos minus zhvlerësimi i akumuluar. Kosto paraqet shpenzimin që i atribuohet direkt blerjes.

Një zë nga pajisjet dhe makineritë largohet nga bilanci i gjendjes kur shitet ose kur tërhiqet nga përdorimi dhe kur nuk pritet ndonjë benefit i ardhshëm nga ato.

Riparimet dhe mirëmbajtja ngarkohen në pasqyrën operative atëherë kur ndodhin shpenzimet.

Ngarkimi vjetor për amortizimin llogaritet duke përdorur metodën lineare për të gjitha kategoritë e pronës, toka nuk është e zhvlerësuar dhe behet për çdo muaj.

Shpenzimet pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të asetit apo janë njohur si asete të ndara, në mënyrën e duhur, vetëm atëherë kur përfitimi ekonomik i mundshëm lidhur me to mund të rrjedhë në Kompani dhe vlera e mjetit mund të matet seriozisht.

Shkalla e zhvlerësimit të aseteve sipas përcaktimit të vlerësuesve mbi jetën e përdorimit dallon nga shkalla e zhvlerësimit sipas dhe janë të aplikuara sipas Rregulloreve në fuqi:

- Ndertesat 5%,
- Pajisjet dhe makineria 10%,
- Pajisjet tjera me 20%,

2.3 Zhvlerësimet e aseteve

Prona, impiantet dhe pajisjet rishikohen për dëmtim kurdo që ndonjë ngjarje ose ndryshimet në bazë të rrethanave tregojnë se shuma bartëse e një asemi nuk mund të rikuperohet. Kurdo që vlera bartëse e një asemi të tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme, një humbje nga rënia në vlerë njihen në të ardhura. Vlera e rikuperueshme e një

aseti është çmimi më i lart shitës neto i një asemi dhe vlera në përdorim. Çmimi neto i shitjes është shuma e aritshme nga shitja e një asemi në një transaksion të vullnetit të lirë, përderisa vlera në përdorim është vlera aktuale e paraparë në të ardhmen e flukseve të parasë që pritet të arrijnë nga përdorimi i vazhdueshëm të një asemi dhe nga heqja e tij në fund të jetëgjatësisë së përdorimit të tij. Vlerat e rikuperueshme llogariten për asetet individuale ose, nëse nuk është e mundur, për njësitë që gjenerojë të holla.

2.4 Asetet e paprekshme

Asetet e paprekshme përbëhen nga softuerët e licencuar për kompjuter (navision). Këto fillimisht deklarohen sipas kostos së tyre dhe më pas sipas kostos minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar të dëmtimeve, nëse ka pasur. Amortizimi regjistrohet kur këto aset janë në dispozicion për përdorim duke përdorur metoden lineare përderisa kostoja e një asemi të paprekshëm shlyhet përgjat kohzgjatjes së vlerësuar të përdorimit.

2.5 Instrumentet financiare

Asetet financiare dhe detyrimet financiare njihen kur Kompania bëhet pjesë e dispozitave kontraktuese të instrumentit financiar. Asetet financiare nuk njihen kur të drejtat e kontraktuara mbi rrjedhën e parasë nga asemi financiar skadon, ose kur asemi financiar dhe të gjitha rreziqet e konsiderueshme dhe shpërblimet janë transferuar. Detyrim financiar nuk njihet kur ai është shuar, shlyer, anuluar apo skaduar.

Asetet financiare dhe detyrimet financiare janë matur fillimisht me vlerën e drejtë, plus kostot e transaksioneve, me përjashtim të aseteve dhe detyrimeve financiare të bartura në vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes, të cilat fillimisht janë matur me vlerën e drejtë. Asetet financiare dhe detyrimet financiare janë matur më pas ashtu si përshkruhet më poshtë.

2.6 Asetet financiare

Kompania klasifikon asetet e saj financiare në këto kategori si në vijim: pasuritë financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kredive dhe të arkëtueshmeve dhe aseteve financiare në dispozicion për shitje (AFS). Menaxhmenti klasifikon investimet e tij në momentin e njohjes së tyre fillestare.

2.7 Mjetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Asetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë asetet financiare të mbajtura për tregti. Asemi financiar klasifikohet në këtë kategori nëse kryesisht është përvetësuar për qëllim shitje në afat të shkurtër. Asetet në këtë kategori janë klasifikuar si asetë qarkulluese. Kompania nuk ka asetë të klasifikuar në këtë kategori deri në datë të raportimit.

2.8 Kreditë dhe të arkëtueshmet

Huat dhe të arkëtueshmet janë asetë financiare jo-derivateve me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Këto janë të përfshira në asetet qarkulluese, me përjashtim të kredive dhe të arkëtueshmet që kanë maturitet në më shumë se 12 muaj që nga data e bilancit të gjendjes. Kreditë dhe të arkëtueshmet e Kompanisë në datën e bilancit të gjendjes përbëhet nga të arkëtueshmet tjera dhe tregtare, paraja dhe ekuivalentët e parasë.

2.9 Stoqet

Stoqet e INFRAKOS SH.A. janë kryesisht materiale dhe pjesët rezervë të cilat janë të lidhura kryesisht me funksionimin e rrjetit hekurudhor. Vlera e stoqeve është vlerësuar me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme, duke përdorur metodën e matjes mesatare dhe përfshin shpenzimet e kryera në përvetësimin e stoqeve dhe sjelljen e tyre në lokacionin ekzistues dhe gjendjen ekzistuese të tyre.

Këto materiale dhe pjesë rezervë fillimisht janë regjistruar në stoqe, e më pas janë shpenzuar ose kapitalizuar në momentin e instalimit.

2.10 Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë bartur në shumat e faturuara siq janë reduktuar nga provizioni i bërë për dëmin e tyre. Provizioni për borgjet e këqija është vendosur kur ka evidencë objektive se Kompania nuk do të jetë në gjendje ti mbledhë të gjitha shumat e pritura .

2.11 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë mbahen në bilancin e gjendjes sipas kostos. Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë së gatshme, paraja përfshinë paranë në dorë dhe depozitat e mbajtura në bankë të pa afatizuara.

2.12 Kapitali aksionarë

Kapitali aksionarë përbëhet nga vlera monetare e kontribuar , e regjistruar në librat e Kompanisë në shumën prej 25,000.00€ e qe në këtë vite është zvogëluar për shumën e terhequr nga gjykata.

2.13 Rezervat

Rezervat fillimisht janë njohur në gjendjen fillestare të bilancit të gjendjes në mes të vlerës reale të pasurive neto dhe vlerës së kapitalit fillestar, të kontribuar nga aksionarët e Kompanisë.

2.14 Përfitimet e punëtorëve

Në rrjedhat normale të biznesit, entiteti bënë pagesat në emër të punëtorëve të vetë për kontributet pensionale dhe tatimet në të ardhurat personale të cilat janë të kalkuluara në bazë të pagave bruto sipas legjislacionit në fuqi. Këto shpenzime i ngarkohen pasqyrave të të ardhurave për periudhën e caktuar kohore.

2.15 Tatimi

“Infrakos” SH.A është kërkuar që të paguajë tatim në fitimin e realizuar për çdo periudhë financiare kontabile të kalkuluar në përputhshmëri me Rregulloret në fuqi, për periudhën e caktuar, si dhe tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin dhe kontributet në të ardhura personale.

Sipas legjislacionit aktual tatimor, humbjet e tatimit mundë të barten për tu vendosur në katër(4) vitet pas vitit kur ka ndodhur humbja.

2.16 Njohja e të hyrave operative

– Të hyrat e Kompanisë janë kryesisht të hyra të cilat realizohen nga veprimtaria primare e Qasja ne binare dhe qiraja njihen në momentin e faturimit.

Të hyrat njihen kur është e mundur që fitimet ekonomike lidhur me rrjedhen e transaksioneve të Kompanisë dhe kur shuma e të hyrave mundë të matet besueshëm dhe kur kriteret për secilin nga aktivitetet e ndryshme të kompanisë janë përmbushur. Këto kriteret të njohjes së aktiviteteve-specifike janë të bazuara në mallrat ose zgjidhjet e siguruar ndaj klientit dhe kushteve të kontratës në secilin rast, dhe janë përshkruar më poshtë

Të hyrat nga koha dhe kontratat materiale njihen sipas metodës së përqindjes së kompletimit. E hyra njihet përgjithësisht bazuar në çmimin e kontraktuar. Për kontratat e kohës, faza e kompletimit është matur në bazë të orëve të punës dorëzuar si përqindje e totalit të orëve që do të dorëzohen. Për kontratat materiale, faza e përfundimit është matur në bazë të shpenzimeve të drejtpërdrejta të shkaktuara si një përqindje e shpenzimeve totale që do të ndodhin. Të hyrat nga kontratat me çmime fikse për ofrimin e shërbimeve të transportit në

përgjithësi njihen në periudhën që shërbimet janë siguruar, duke përdorur metodën drejtë-vizore mbi afatin e kontratës.

Nëse lindë ndonjë rrethanë që mund të ndryshojnë vlerësimin origjinal të të hyrave, kostove ose shkallën e progresit drejt përfundimit, vlerësimet korrigjohen. Këto rishikime mund të rezultojnë në rritje apo zvogëlime në të ardhurat ose shpenzimet e vlerësuara dhe pasqyrohen në të ardhura në periudhën në të cilën rrethanat që shkaktuan iniciimin e rishikimit bëhet i njohur nga menaxhmenti.

2.17 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin e kryerjes së shërbimit ose në datën e faturimit.

2.18 Shpenzimet e huazimit

Shpenzimet e huazimit kryesisht përbëhen nga interesi mbi huazimet e Kompanisë. Të gjitha kostot e huamarrjes, duke përfshirë koston e huamarrjes drejtpërdrejtë i atribuhet përvetësimit, ndërtimit apo prodhimit të një asemi te caktuar, janë shpenzuar në periudhën në të cilën ato janë shkaktuar dhe raportuar në 'kostot financiare'.

2.19 Grantet qeveritare

Grantet nga qeveria janë njohur me vlerën reale ku është një siguri e arsyeshme se grantet do të mirren dhe Kompania do ti përmbush kushtet e bashkangjitura.

Grantet qeveritare lidhur me blerjen e paisjeve, pronës dhe impianteve janë të përfshira në detyrimet jo qarkulluese si grant qeveritar i shtyrë dhe janë kredituar në pasqyrën e të ardhurave në bazë drejtëvizore sipas shkallës së zhvlerësimit për kategorinë e caktuar. Grantet qeveritare që lidhen me shpenzimet janë të shtyra dhe njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave gjatë periudhës së nevojshme që të përputhen ato me shpenzimet që ato kanë për qëllim për ti kompensuar.

2.20 Detyrimet kontingjente

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen vetëm nëse mundësia e një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët.

Si detyrim kontingjent shpalosen paditë e të punësuarve si kërkesa potenciale ndaj kompanisë në vlerë të përafërt rreth 204 mijë euro, e trashëguar me rastin e ndarjes nga Hekurudhat e Kosovës Sh.A.

2.21 Provizionet, detyrimet kontingjente dhe asetet kontingjente

Provizionet njihen kur detyrimet e tanishme si rezultat i një ngjarje në të kaluar mund të çojë në një fluks dalës të burimeve ekonomike nga grupi ku shumatat mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Koha apo shuma e daljeve mund të jetë ende e pasigurt. Një detyrim i tanishëm lind nga prania e një zotimi konstruktiv ose detyrimi ligjor që ka rezultuar nga ngjarjet e kaluara. Provizionet nuk njihen për humbjet operative në të ardhmen.

Provizionet maten me shpenzimet e parashikuara të nevojshme për të shlyer obligimin e tanishëm, duke u bazuar në dëshmi të besueshme në dispozicion në datën e raportimit, duke përfshirë rreziqet dhe pasiguritë lidhur me detyrimin e tanishëm. Aty ku ka një numër të detyrimeve të ngjashme, gjasat që një fluks dalës do të kërkohej në shlyerje të obligimit përcaktohet duke marrë në konsideratë klasën e detyrimeve si tërësi. Provizionet zbriten në vlerën e drejtë të tyre, kur vlera kohore e parasë është materiale.

Të gjitha provizionet rishikohen në çdo datë të raportimit dhe rregullohen për të reflektuar vlerësimin më të mirë aktual.

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen vetëm nëse mundësia e një dalje të buri-meve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një pasuri kontingjente nuk njihet në pasqyrat financiare, por shpaloset kur një fluks hyrës i përfitimeve ekonomike është i mundshëm.

Shuma e një humbje kontingjente njihet si provizion nëse ka gjasa që ngjarjet e ardhshme do ta konfirmojnë që, një detyrim ka ndodhur deri në datën e bilancit të gjendjes dhe një vlerësim i arsyeshëm i humbjes së shkaktuar mund të bëhet.

2.2 Adaptimi i Standardeve të reja dhe të reviduara

a) Standardet dhe interpretimet që hyjnë në fuqi në periudhën e tanishme

Ndryshimet si në vijim për standardet ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (IASB) janë efektive për periudhën aktuale të raportimit:

a) Standardet dhe interpretimet që hyjnë në fuqi në periudhën e tanishme

- SNK 19 "Përfitimet e punonjësve" (hyn në fuqi në periudhën vjetore që fillon më apo pas 1 janar 2019),
- SNRF 9 "Instrumentet financiare" (hyn në fuqi në periudhën vjetore që fillon më apo pas 1 janar 2019),
- SNK 28 "Investimet në pjesmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta" (hyn në fuqi në periudhën vjetore që fillon më apo pas 1 janar 2019),
- SNRF 16 "Qiratë" (hyn në fuqi në periudhën vjetore që fillon më apo pas 1 janar 2019),

Adaptimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese dhe interpretimet nuk ka ndikuar në ndonjë ndryshim të pasqyrave financiare të Kompanisë.

b) Standardet dhe interpretimet që nuk hyjnë në fuqi në periudhën e tanishme

- Ndryshimet në IFRS 10 "Pasqyrat e Konsoliduara Financiare" dhe IAS 28 "Investimet në Ortakëri dhe Sipërmarrje të Përbashkët" – Shitja apo Kontributi i Pasurisë në mes të Investitorit dhe Ortakërisë apo Sipërmarrjes së Përbashkët dhe ndryshime të mëtejshme (data e hyrjes në fuqi shtyhet në një afat të pacaktuar derisa të projekti kërkimor për metodën e ekuitetit përfundon).
- Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat e Konsoliduara Financiare" dhe IAS 28 "Investimet në Ortakëri dhe Sipërmarrje të Përbashkët" – Shitja apo Kontributi i Pasurisë në mes të Investitorit dhe Ortakërisë apo Sipërmarrjes së Përbashkët dhe ndryshime të mëtejshme (data e hyrjes në fuqi shtyhet në një afat të pacaktuar derisa të projekti kërkimor për metodën e ekuitetit përfundon).
- SNRF 17 "Kontratat e sigurimit" do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhën kontabël që fillon më ose pas dates 01 janar 2021.

Kompania ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre në fuqi. Kompania parashikon që adaptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e zbatimit fillestar.

3. Rreziqet e Kompanisë

3.1. Rreziku financiar menaxhues

Rreziku i menaxhimit të Kompanisë bartet nga Bordi i Drejtorëve. Rreziku i Menaxhmentit është fokusuar në pa mundësinë për të parrashikuar ecuritë e tregjeve globale, andaj dhe mundohet të i minimizoi efektet e kundërta mbi performancën biznesore të Kompanisë. Theks të posaqëm lidhur me rrezikun financiar

Menaxhmenti i Kompanisë i ka vënë vetës që të gjendet metoda efektive dhe efikase për arkëtimet me kohë të të arketueshmeve të tjera dhe tregëtare nga dhënja e pronave me qira.

3.2 Risku i tregut

Risku i tregut është risk që ndryshon në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit të huaj, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit do të ndikojë në të ardhurat e kompanisë ose vlerën titujve të instrumenteve financiare të saj. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhoj dhe kontrolloj ekspozimin ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, derisa optimizon kthimin.

3.3 Risku i monedhës

Kompania për ushtrimin vitin 2019 nuk i është e ekspozuar riskut të monedhës pasi që ka operuar vetëm në valutën Euro (EUR).

3.4 Rreziku kreditor

Kompania ka koncentrim domethënse të rrezikut kreditor. Kompania ka politika të vendosura që ofrimi i shërbimeve në traset hekurudhore apo dhënja me qira e pronave u bëhen klientëve që në shumë raste nuk mund ti zgjedhë. Kompania mundohet të aplikoj politika të cilat në një masë i limitojnë shumat e ekspozuara të ndonjë kundër partneri. Maksimumi i ekspozimit të Kompanisë ndaj rrezikut kreditor prezantohet nga shuma bartëse për secilin mjet financiar në Bilancin e gjendjes. Theksimet e lartëcekura janë të lidhura edhe me këtë rrezik që Menaxhmenti i Kompanisë mundohet ta zgjedh për afate të gjata dhe në perspektivë

3.5 Risku i likuiditetit

Kompania menaxhon nevojat e saj të likuiditetit duke monitoruar kujdesshëm pagesat e borxheve për detyrimet financiare afatgjate, si dhe hyrjet e parave të parashikuara dhe daljet e parasë nga aktivitetet e përditshme të biznesit. Nevojat për likuiditetin monitorohen në kohë të ndryshme, në bazë ditore dhe javore, si edhe në bazë të një projektimi përsëritës 30 ditësh. Nevojat e likuiditetit afatgjatë për një periudhë në vërtetim prej 180 ditësh dhe 360 ditësh identifikohet çdo muaj. Kërkesa neto e parave krahasohet me mundësitë në dispozicion të huamarrjes në mënyrë që të përcaktoj ndonjë tepricë apo ndonjë mungesë.

3.6 Menaxhimi i rrezikut kapital

Objektivat e Kompanisë sa i përket menaxhimit të kapitalit janë të ruajë mundësinë që Kompania të vazhdojë vijueshmërinë në mënyrë që të siguroi kthimin e benefiteve për aksionerët dhe përfitime për aksionerët tjerë, si dhe të mirëmbaj një strukturë optimale të kapitalit për të ulë koston e kapitalit. Në mënyrë të mirëmbajtjes apo rregullimit të strukturës së kapitalit, Kompania mund ta Risë apo kthejë kapitalin te aksionerët apo dhe të i shes pasuritë që t'i ulë detyrimet e lindura me maturitet të shkurtër.

3.7 Parashikimi i vlerës së drejtë (fer)

Të arketueshmet tregëtare dhe tjera të Kompanisë, pasuritë likuide dhe detyrimet tjera dhe tregëtare kanë maturitet të shkurtër, si pasojë vlera e tyre bartëse korrespondon me vlerën reale të tyre.

4. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

	2019	2018
	€	€
Paratë në bankë dhe arkë	166,317	40,846
	166317	40846.33

Teprica përfaqson parat e gatshme dhe ekzistencen e parave te gatshme dhe vlerën e tyre në fund të periudhës.

Kompania transakcionet e veta financiare i realizon edhe me banka. Transakcionet kryhen ne: Pro Credit-Bankë.

5.Llogaritë e arkëtueshme tregëtare dhe të tjera

	2019	2018
	€	€
Transporti i mallrave	41,412	24626
Qiraja	2,586,738	2,340,837
Kërkesat të tjera	1,192,986	1,378,206
Avancet e paguara	-266,137	0.00
Proviz.per borxh.e këqija	-925,481	-816,326
Gjithësejt te arketueshmet Neto	2,629,518	2,927,343

Llogaritë e arkëtueshme mbahen në llogari të veçanta për çdo konsumator për shërbimet tjera që ofron kompania dhe ato paraqiten me vlerën e pritshme të realizuar dhe njihen atëher kur të hyrat ndodhin respektivisht pranohen si të tilla nga blerësit.

Provizionimi i të arketueshmeve tjera dhe tregëtare gjate viti 2019 ka qene në vlerë 109,155.00 euro.

6.Stoqet

	2019	2018
	€	€
Depoja e pjesëve rez.nga BKK	384,750	422,663
Nafta	1,961	1,961
Depoja kryesore/HU	25,277	12,212
Loco depo/HU	35,891	35,957
Depo vajrave dhe lyerseve etj.	3,721	2,648
Depoja e SS dhe TK/HU	349,081	356,930
Depoja e binareve/HU	3200	3204
Depo ne stacion	197	2650
	804,078	838,225

Stoqet janë paraqitur me çmimin më të ulët ose në vlerën e realizueshme neto. Shpenzimet e shkaktuara gjatë vendosjes së secilit zë të stoqeve në vendin e tyre të tanishëm dhe konditat janë llogaritur për lëndë të parë dhe për të mira konsumuese si çmim i blerjes sipas metodës së vlerës mesatare.

Vlera e realizueshme neto është lartësia e çmimit të kalkuluar në shpenzimet e zakonshme të biznesit, duke zbritur shpenzimet e kalkuluara të vlerës përfundimtare dhe shpenzimet e llogaritura të nevojshme për kryerjen e shitjes.

Provizionet përkatëse të bazuara në përlogaritjet e drejtimit janë bërë për të reflektuar zbritjen e vlerës së stoqeve për shkak të vjetërsisë.

7. Aktivet materiale

	2019 €	2018 €
Toka	10,552,320	10,552,320
Objektet ndërtimore	6,839,798	6,946,548
Pajisjet dhe makineritë	138,687	226,640.71
	18,778,996	19,765,508

Toka, ndërtesa dhe infrastruktura e hekurudhës mandej paisjet , automjetet si dhe inventari janë zërat kryesor të pasurisë së kompanisë. Përmes tabelës më poshtë prezantojmë rrjedhën konsistente të kësaj pasurie:

	Toka €	Ndertesa dhe infra- struktura €	Makinerit BKK €	Makinat- paisjet €	Gjithsejt €
Kosto blerese/vlerësimi					
Me 01 Janar 2018	10,552,320	10,132,791	5,137,113	3,939,625	29,761,850
Shtesat	0		1,606,934	5814	1,612,747
Zvoglimet	0	0	0	0	0
Me 31 Dhjetor 2018	10,552,320	10,132,791	6,744,047	3,945,439	31,374,597
Shtesat	0	38,726	161,356	11,212	211,295
Zvoglimet	0	0	0	0	0
Gjendja me 31 Dhjetor 2019	10,552,320	10,171,517	6,905,404	3,956,651	31,585,892
Zhvlerësimi akumuluar					
Me 01 Janar 2018	0	-3,030,147	-3,496,662	-3,973,046	-10,499,855
Zhvlerësimi për vitin	0	-156,097	-914,617	-38,520	-1,109,234
Më 31 Dhjetor 2018	0	-3,186,244	-4,411,279	-4,011,566	-11,609,089
Zhvlerësimi për vitin	0	-145,476	-1,018,707	-33,624	-1,197,807
Më 31 Dhjetor 2018	0	-3,331,719	-5,429,986	-4,045,190	-12,806,896
Shuma e mbetur					
Me 31 Dhjetor 2019	10,552,320	6,839,798	1,475,417	-88,539	18,778,996

Shenim: Me datën 31 Dhjetor 2019, nuk ka ndonjë artikull të pronës, makinerive, automjeteve dhe paisjeve të lënë peng si garancion në ndonjë fond apo për ndonjë kredimarrje.

8. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

	2019 €	2018 €
Llogaritë e pagueshme tregtare	877,128	1,649,797
	877,128	1,649,797

Llogarit e pagueshme (detyrimet) janë vlerësuar për nga vlera e tyre nominale dhe periudha kohore e tyre dhe ju takojnë detyrimeve për mallërat e blera, shërbimet e kryera ndaj kompanisë.

Detyrimet ndaj furnitorve janë regjistruar si neto e zbritjeve komerciale; Zbritjet njihen në kohën e pagesës. Vlera nominale e këtyre detyrimeve është rregulluar, në rastet e kthimit dhe lejimit (rregullimit të fakturimit), në proporcion me shumën e definuar me palën tjetër.

9. Tatimet e pagueshme aktuale

	2019 €	2018 €
Obligimet ndaj tatimeve	657,044	409,327
Obligimet për kontributin pensional nga Punëdhënësi	466,810	442,364
	1,123,854	851,691

Obligimet për tatime dhe kontribute ju përkasin: obligimet për tatime dhe kontribute në paga.

10. Të hyrat e shtyra

	2019 €	2018 €
Të hyrat e shtyra (grantet)	7,325,294	7,903,987
	7,325,294	7,903,987

Grantet Qeveritare dhe Donacionet për shpenzimet operationale dhe investimet kapitale janë të përfshira në detyrime jo qarkulluese si Grant Qeveritar dhe Donacione të shtyra dhe janë kredituar në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në parimin drejt-vizorë bazuar në jetën e pritur të pasurisë përkatëse. Gjatë vitit 2019, kompania ka pranuar Subvencione nga Qeveria e Republikës së Kosovës në mjete të gatshme në vlerë 1 milion euro.

11. Detyrimet tjera afatshkurtëra

	2019 €	2018 €
Detyrimet tjera afatshkurtëra	149,036	204,842
	149,036	204,842

Ju përkasin mjeteve të marra për që malli apo shërbimi ende nuk është ofruar.

12. Detyrimet e shtyra tatimore

	2019 €	2018 €
Detyrimet e shtyra tatimore	485,591	257,703
	485,591	257,703

Janë obligime të krijuara nga tvsh e faturuar e jo e inkasuar.

13. Kapitali

	2019 €	2018 €
Kapitali themelues (i regjistruar)	3,027	25,000
Rezervat e rivlerësimit	15,226,015	15,226,516
Fitimet/humbjet e bartura	-2,624,644	-2,461,020
	12,604,398	12,790,496

Kapitali aksionar përbëhet nga vlera reale e monetare e evidentuar nga kontributet e aksionereve të Kompanisë. Kapitali aksionar përbëhet nga Kapitali themeltar i Kompanisë, rezervat kapitale të grumbulluara, si dhe rezultatet ekonomike të periudhave të shkuara dhe rezultati ekonomik i periudhës raportuese.

Përmes tabelës në vijim paraqesim ecurinë e kapitalit për dy periudha raportuese:

	Kapitali aksionar €	Fitimet e mbajtura €	Rezervat e tjera €	Gjithsej €
Gjendja më 1 janar 2018	25,000	-1,695,609	15,226,023	13,555,414
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	-764,278		-764,278
Ndarja e rezervave	0	0	0	0
Gjendja më 31 dhjetor 2018	25,000	-2,459,887	15,226,023	12,791,136
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	-163,624	-	-163,624
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	0	0
Dividendat	-	0	0	-
Deponimet e kapitalit shtesë	0	-	-	0
Terheqjet e kapitalit	-21,973	0	0	-21,973
Ndarja e rezervave	-	0	0	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	3,027	-2,623,512	15,226,023	12,605,539

14. Të ardhurat

	2019 €	2018 €
Të ardhurat nga shfrytëzimi i rrjetit - TM	168,658	96,694
Të ardhurat nga shfrytëzimi i rrjetit - TU	348,606	306,914
Të ardhurat nga qiraja	694,189	647,200
Të ardhurat tjera	365,321	298,886
Të ardhurat e shtyra nga grantet BK	1,018,707	914,617
Të ardhurat nga subvencionit per mbul. Tarifa BKK	599,999	586,500
Te hyrat nga grantet dhe subvencioneve	400,000	0
	3,595,480	2,850,811

Të ardhurat kryesisht janë krijuar nga shfrytëzimi i rrjetit hekurudhor për transportin e mallrave, nga shfrytëzimi i rrjetit hekurudhor për transportin e udhëtarëve, të ardhurat nga qiraja dhe të ardhurat tjera për të gjithë konsumatorët, pavarësisht statutin e tyre juridik: persona fizik, biznese, institucione vendore dhe nderkombëtare.

Për vitin 2019, Qeveria e Republikës së Kosovës ka dhënë subvencione në vlerë 1mil euro. Këto subvencione janë dhënë për: shpenzimet e transportit për kompezimin e diferencës për çmimet që ka ul qeveria si dhe për pagesën e obligimeve.

15.Shpenzimet operative

Shpenzimet kanë ndodhë nga zhvillimi i aktiviteteve operuese të kompanisë. Pranohet në relacion me destinimin funksional të shpenzimeve të natyrës të mbetur (tepricave). Në vijim shpalosen më detalisht këto shpenzime:

Shpenzimet e personelit

	2019 €	2018 €
Pagat bruto për personelin	1,980,857	2,003,336
Kontributet pensionale nga Punëdhënësi për të punësuarit	99,044	100,168
	2,079,901	2,103,504

Shpenzimet për personel-Artikulli i mbulon koston e plotë të punonjësve duke përfshirë përmirësimet e meritave, lëvizjes në mes kategorive, shpenzimet e paparashikuara, kostoja e pushimeve të pa shfrytëzuara dhe dispozitat e ligjit.

Numri i të punësuarve më 31 dhjetor 2019 ka qenë: 308 të punësuar ndërsa për vitin paraprak 311 të punësuar.

Shpenzimet e zhvlerësimit

	2019 €	2018 €
Zhvlersimi i ndertesave	261,613	262,741
Zhvlersimi i Rrjetit	364,810	371,099
Zhvlersimi i automjeteve	17,615	21,494
Zhvlersimi i paisjeve	541,574	433,783
Zhvlersimi i inventarit	12,194	20,116
	1,197,807	1,109,233

Shpenzimet operative (vazhdim)

	2019	2018
	€	€
Shpenzimet e energjisë elektrike	102,240	117,985
Shpenzimet e karburanteve	36,020	47,307
Shpenzimet e telefonit	14,732	18,520
Mirëmbajtjet e rrjeteve	24,846	21,147
Mirëmbajtjet e paisjeve	4,938	16,892
Materialet hargjuese operative	36,156	30,457
Riparimet	13,119	17,401
Sherbimet tjera operative	1,502	1,369
Udhëtime zyrtare	6,676	9,213
Shpenz e marketingut dhe publikimeve	6,252	6,531
Materiali i zyrës dhe hargjimeve	9,105	10,958
Shpenz gjyqesore	92,984	6,165
Shpenzimet e reprezentacionit	5,046	8,781
Shpenz e sigurimit	8,838	9,276
Shpenz e stafit jashtëm	185	1,587
Shpenz financiare(provizioni bankar)	741	1,124
Shpenzimet tjera operative	118,016	78,752
	481,397	403,465

16. Fitimi/humbja paratitimeve

	2019	2018
	€	€
Fitimi /humbja para tatimit	-163,624	-764,278
	-163,624	-764,277

Pas zbritjes të gjitha shpenzimeve, vërehet se kompanija ka paraqitur rezultat negativ financiarë në vlerë -- 163,624.00euro.

17. Tatimi në të ardhurat e korporatave

Harmonizimi i shpenzimeve të tatimit në të ardhurat e korporatave i zbatueshëm për profitin nga aktivitetet operative para zbritjes së tatimit në të hyra, sipas shkallës ligjore për tatimin në të hyra ndaj shkallës së zbatueshme të tatimit në të hyra të ndërmarrjes për vitet e përfunduara më 31 dhjetor është si në vijim:

Përshkrimi	Vlera në €
E ardhura/humbja para tatimit	-163,624
Shtimi me rregullime	
Zvoglimi me rregullime-kontributet humanitare	0
Baza për llogaritjen e tatimit	-163,624
Shkalla tatimore	10%
Obligimi tatimor	0.00
Kestet e paguara gjate vitit	0.00
Ma pakë paguar	0.00
Ma tepër paguar	0.00

Nga të dhënat e prezentuara në tabelën lartë vërehet se kompania nuk ka pasë obligime për ushtrimin nën auditimin ndaj tatimit në të ardhurat e korporatave, pasi që ka afaruar me rezultat negativë financiarë dhe është e liruar nga tatimi në të ardhurat e korporatave sipas kërkesave të rregullave për tatime.

Rregullat e nenit 6 të Ligjit Nr. 05/L-29 Për tatimin mbi të ardhurat e Korporatave e rregullojnë materjen për tatimet në të ardhura dhe përcaktojnë që shkalla e tatimit është 10%.

Sipas rregullave të nenit 23 pika 2 të Ligjit Nr. 05/L-29 Për tatimin mbi të ardhurat e Korporatave, humbja tatimore mund të bartet në katër (4) periudhat të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

18. Pasuritë dhe detyrimet e kushtëzuara (kontigjente)

Sipas Raportit Vjetor Financiar 2019, në vitin 2019 kompania ka qenë edhe palë e paditur si dhe palë paditëse.

19. Ngjarjet pas datës së Bilancit

Drejtimi i kompanisë nuk ka prezentuar ndonjë rastë që mundë të ketë ndikim në pasqyrat financiare të datës 31 dhjetor të vitit 2019, mirëpo menjëher pas miratimit të PF 2019, Aksionari-Qeveria e Kosovës ka shakruar Bordin e Drejtorëve.

Në mesin e muajit Mars 2020 ka ndodhë arritja e pandemise COVID-19 në Republikën e Kosovës ku ka rezultuar në ndërprerjen e disa aktiviteteve edhe për kompanin tone, se kur ndodh fillimi i aktiviteteve normale afariste mvaret nga lejet nga autoritetet qeveritare. Si rezultat i përhapjes së koronavirusit COVID19, janë krijuar paqartësi ekonomike që ka të ngjarë të ndikojnë negativisht në të ardhurat neto edhe për ndërmarrjen tonë. Efekte të tjera financiar mund të ndodhin megjithëse ndikimi i tillë i mundshëm nga to është i panjohur në këtë kohë.

20. Parimi i Vijimësisë

NP Infrakos subvencionohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik për të financuar (mbuluar) projektet për investime kapitale, mirëpo edhe përkundër kësaj infrastrukture e Hekurudhave në Kosovë është në gjendje të vështirë dhe paraqet një problem mjaft të madh për vendin tonë.

Për shkak të vështërsive të afarizmit, NP Infrakos ka operuar me humbje financiare ku shpenzimet e përgjithshme janë më të larta se të hyrat operative. Aksionari dhe Bordi i drejtorëve duhet të jenë më aktiv për të shqyrtuar të gjitha aktivitetet e kryera nga menaxhmenti krahas rezultateve të arritura.